

**URDHËR**  
**Nr. 82, datë 22.2.2016**

**PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË MËSIMORE TË INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT  
PARAUNIVERSITAR PRIVAT TË SHOQËRISË “FLABINA”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 70, të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

**URDHËROJ:**

1. Mbylljen e veprimtarisë mësimore të institucioneve të arsimit parauniversitar privat, që i përkasin shoqërisë “Flabina”, si më poshtë:

<b>Nr.</b>	<b>Emri i shkollës</b>	<b>Akti i licencimit</b>	<b>Njësia arsimore vendore</b>
1	Shkolla e mesme teknike ekonomike “Flabina”	Urdhri nr. 336, datë 7.11.2000, “Për dhënie leje funksionimi të institucionit arsimor jopublik”	Drejtoria Arsimore Rajonale e Qytetit Tiranë
2	Shkolla e mesme sportive “Flabina”	Urdhri nr. 381, datë 10.10.2006, “Për funksionimin e institucionit arsimor privat parauniversitar, shkollë e mesme sportive “Flabina”	Drejtoria Arsimore Rajonale e Qytetit Tiranë
3	Shkolla e mesme e përgjithshme e profilizuar “Flabina”	Urdhri nr. 382, datë 10.10.2006, “Për funksionimin e institucionit arsimor privat parauniversitar, shkollë e mesme e përgjithshme e profilizuar “Flabina”	Drejtoria Arsimore Rajonale e Qytetit Tiranë
4	Shkolla e mesme e gjuhëve të huaja “Flabina”	Urdhri nr. 261, datë 24.7.2007, “Për funksionimin e institucionit arsimor privat parauniversitar, shkollë e mesme e gjuhëve të huaja “Flabina”	Drejtoria Arsimore Rajonale e Qytetit Tiranë

2. Institucionet arsimore private parauniversitare që i përkasin shoqërisë “Flabina”, të përmendur në pikën 1 të këtij urdhri, kanë këto detyrime:

a) Të mbyllin të gjitha detyrimet lidhur me veprimtarinë mësimore për vitin mësimor 2015–2016, brenda afateve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;

b) Të pajisin çdo nxënës, me të gjithë doku-mentacionin e nevojshëm shkollor, që do të shërbejë për transferimin e tij në një institucion tjetër të arsimit parauniversitar publik, brenda datës 29.2.2016;

c) Të vënë në dispozicion të Drejtorisë Arsimore Rajonale të Qytetit Tiranë çdo infor-macion të kërkuar dhe të vazhdojnë të mbajnë kontakte me të deri në plotësimin dhe mbylljen e të gjitha kërkesave të parashikuara në këtë urdhër;

d) Të kthejnë pagesat e kryera nga nxënësit për pjesën e papërfunduar të shkollimit, si dhe çdo detyrim tjetër të papërbushur që mund të kenë ndaj nxënësve;

e) Të dorëzojnë në Drejtorinë Arsimore Rajonale të Qytetit Tiranë të gjithë dokumenta-cionin lidhur me veprimtarinë mësimore të kryer.

3. Të gjitha shpenzimet për kryerjen e procedurave për transferimin e nxënësve, në zbatim të këtij urdhri, të përballohen nga ana e institucioneve arsimore private të përmendura në pikën 1 të këtij urdhri/personit juridik privat që i përfaqëson, shoqërisë “Flabina”.

4. Drejtoria Arsimore Rajonale e Qytetit Tiranë, ka për detyrë:

a) Të ngrejë brenda datës 25.2.2016, grup të posaçëm pune për monitorimin e zbatimit të këtij urdhri për institucionet arsimore private parauniversitare të përmendura në pikën 1 të këtij urdhri, që i përkasin shoqërisë “Flabina”. Grupi i punës të menaxhojë transferimin e nxënësve në institucionet e arsimit parauniversitar publik.

b) Të ruajë në arkivin e saj dhe më tej të arkivojë, sipas ligjit për arkivat, dokumentacionin e dorëzuar nga institucionet arsimore private parauniversitare, të përmendura në pikën 1 të këtij urdhri, që i përkasin shoqërisë “Flabina”.

5. Ministria e Arsimit dhe Sportit të marrë masa të tjera të mëtejshme, sipas parashikimeve të Kodit Civil, ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi, për personin juridik shoqëria “Flabina”, që përfaqëson institucionet arsimore private parauniversitare, të përmendura në pikën 1 të këtij urdhri, në rast se ai nuk e zbaton këtë urdhër.

6. Ministria e Arsimit dhe Sportit t’i kërkojë Qendrës Kombëtare të Licencimit kryerjen e veprimeve ligjore për çregjistrimin e subjektit të licencuar shoqëria “Flabina”.

7. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria Arsimore Rajonale e Qytetit Tiranë dhe subjekti juridik, përfaqësues i institucioneve arsimore private parauniversitare, të përmendura në pikën 1 të këtij urdhri, shoqëria “Flabina”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT  
**Lindita Nikolla**